



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 26.04.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi miratimin kërkesave buxhetore për programin buxhetor afatmesëm (PBA) 2025-2027, për sistemin gjyqësor, (faza e parë)”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:05 dhe mbaroi në orën 13:51.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Klodian Kurushi* (anëtar)
3. *Fatmira Luli** (anëtare)
4. *Irena Plaku** (anëtare)
5. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro** (anëtar)
8. *Markelian Koça** (anëtar)

9. Yllka Rupa* (anëtare)

10. Emona Muçi (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Illir Rusi.**

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

4. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

5. Denisa Varfi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi miratimin kërkesave buxhetore për programin buxhetor afatmesëm (PBA) 2025-2027, për sistemin gjyqësor, (faza e parë)”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Përsëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Siç jeni në dijeni kemi përfshirë sot në mbledhjen e radhës miratimin e kërkesave buxhetore për programin buxhetor afatmesëm (PBA) 2025-2027, për sistemin gjyqësor, (faza e parë), i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Më tej, për shkak të urgjencës kemi caktimin e gjyqtarit në një gjykatë në nevojë.

Gjithashtu, meqë ishte pjesë e shorteve, kemi përfshirë edhe fillimin e procedurave për përzgjedhjen e kandidatëve për lëvizjen paralele në Gjykatën Administrative, duke qenë se kemi për të hedhur shortin edhe për këtë.

Pa humbur kohë, në fakt akti më i rëndësishëm është faza e parë e buxhetit afatmesëm, kështu që fjalën unë ia jap Drejtorit të Departamentit z. Haxhiu i cili do të ndalojë në çdo fazë, të na shpjegojë shumë mirë për çfarë ne do synojmë, duke dhënë edhe mundësinë që kemi prapë hapësirë që brenda gushtit ne të rishikojmë këtë lloj gjëje.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Siç është bërë traditë, është koha e hartimit të dokumentit të programit buxhetor afatmesëm për periudhën 2025-2027 për sistemin gjyqësor. Është dokumenti për fazën e parë strategjike e cila është hartuar duke u mbështetur në vizionin, misionin, qëllimin, synimet dhe objektivat strategjike të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Deklarata e misionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në funksion të përgatitjes së kërkesave buxhetore, është të ndërtojë, udhëheqë dhe qeverisë një gjyqësor me performancë të lartë, që kërkon ekselencë dhe meriton besimin e publikut. Në funksion të kësaj është hartuar miruar dhe vizioni I KLGJ-së, misioni i KLGJ-së, deklarata e politikës së programit si grup buxhetor, qëllimi i politikës së programit si grup buxhetor.

Kërkesat buxhetore, për fazën e parë strategjike, janë përgatitur duke u mbështetur në legjislacionin buxhetor në Republikën e Shqipërisë ashtu edhe në tavanët përgatitor të miratuara si dhe nga historiku i realizimit të shpenzimeve sipas programit gjatë vitit buxhetor 2023 si dhe buxhetit të miratuar për vitin 2024 të ndarë në tre programe buxhetore:

Në programin 01110 “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, ku përfshihen kërkesat buxhetore, për funksionimin e institucionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Programin 01140 – “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”, ku përfshihen kërkesat buxhetore për funksionimin e Qendrës së Teknologjisë së

Informacionit (QTI) për sistemin e drejtësisë.

Programin 03310 - “Buxheti Gjyqësor”, ku përfshihen kërkesat buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së gjykatave në të tre nivelet.

Kërkesa buxhetore për vitin 2025, për të tre programet është në total programuar në shumën prej 8,047,500 mijë lekë.

Dua të theksoj këtu se kërkesat buxhetore për sistemin gjyqësor (KLGJ-në, Gjykata dhe QTI) për vitin 2025 janë programuar në shumën 8,047,500 mijë lekë dhe krahasuar me kërkesat buxhetore të programuara po në të njëjtë fazë të PBA 2024-2026, të cilat ishin në shumën 6,685,450 mijë lekë, janë më të larta në masën 20%, rritje e cila konsiston nga rritja e shpenzimeve të personelit, si rrjedhojë e ndryshimit të pagës referuese bazë të magjistratit (gjyqtar), po ashtu edhe të administratës si të KLGJ-së ashtu edhe të administratës gjyqësore, si dhe nga rritja e kërkesave në shpenzime kapitale (investime) për të gjithë sistemin.

Po kështu, tavanët përgatitore të miratuara për sistemin gjyqësor për vitin 2025 të cilat janë në shumën 4,897,459 mijë lekë, krahasuar me buxhetin e miratuar të sistemit gjyqësor, për vitin 2024 është në shumën 4,967,459 mijë lekë, janë më të ulëta në vlerë absolute në shumën 70,000 mije lekë ose në masën 1.4%. Pra dua të theksoj se edhe tavanët e miratuara për vitin 2025 janë më të vogla sesa buxheti i miratuar për vitin 2024.

Kërkesat buxhetore, për të tre programet, paraqiten sipas pasqyrës së mëposhtme (të gjithë e keni materialin përpara).

Siç shikohet, kërkesat buxhetore për vitin 2025, janë në shumën 8,047,500 mijë lekë, ndërsa tavanet përgatitore janë në shumën 4,897,459 mijë lekë, pra kërkesat janë në masën 64% më të larta se tavanet e miratuara ose në vlerë absolute 3,150,041 mijë lekë.

Kërkesat buxhetore për programin “Planifikim, Menaxhim, Administrim”, janë programuar në shumën 446,100 mijë lekë, dhe zënë 5.5 %, të totalit të kërkesave për sistemin gjyqësor.

Kërkesat buxhetore për programin “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”, janë në shumën prej 19,000 mijë lekë dhe zënë 0,2% e kërkesave buxhetore të sistemit gjyqësor.

Kërkesat buxhetore për programin “Buxheti gjyqësor”, të cilat janë programuar në shumën 7,582,400 mijë lekë ose në masën 94.3% të kërkesave për sistemin gjyqësor.

Më poshtë po kalojmë në përshkrimin/detajimin e kërkesave buxhetore sipas programeve buxhetore.

Programi buxhetor 01110 - “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”.

Në këtë program përfshihen kërkesat buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kërkesat buxhetore janë bazuar në përshkrimin e programit, qëllimi i politikës së programit, treguesit e performancës në nivel qëllimi, objektivi i programit, treguesit e performancës në nivel objektivi, produktet e programit të cilat: shpenzimet korrente (vendimet e miratuara nga KLGJ-ja) si dhe shpenzimet kapitale ë cilat konsistojnë në blerje pajisjes, rikonstruksion ndërtimi, projekte për softuerë dhe blerje mjete motorike.

Kërkesat buxhetore për këtë program janë në masën 446,100 mijë lekë, ku shpenzimet korrente janë 56,679 mijë lekë mbi tavanet e miratuara, ndërsa shpenzimet kapitale janë në të njëjtin nivel me tavanet përgatitore të miratuara.

Shpenzime Korrente ku përfshihen shpenzime paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative, dhe shpenzimet për transfertat dhe buxhetet familjare dhe individët, janë programuar në shumën 431,100 mijë lekë. Shpenzimet e personelit janë në vlerën 356,450 mijë lekë, të cilat, janë 56,679 mijë lekë mbi tavanet e miratuara.

Në artikullin “Shpenzime për paga”, rezulton në shumën 316,000 mijë lekë.

Programimi i kërkesave buxhetore për shpenzime të pagave është bërë duke u mbështetur në legjislacionin për pagat në fuqi dhe numri i miratuar i punonjësve 131 vetë sipas organigramës të institucionit. Ndërsa për vitin 2025, është kërkuar dhënia shtesë prej 3 punonjësish për pozicionin “Shef Sektori në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore” dhe 2 punonjës “Specialistë”, ku efekti financiar i tyre është 4,300 mijë lekë dhe do të përballohet brenda fondit të kërkuar nga ana jonë sa më sipër.

Po ashtu në artikullin “Shpenzime për Sigurime Shoqërore e Shëndetësore”, rezulton në shumën 40,450 mijë lekë, të cilat janë programuar duke u përlllogaritur sipas legjislacionit të fuqi.

Në shpenzime operative, artikulli 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” rezulton në shumën 73,150 mijë lekë. Këto kërkesa janë hartuar duke pasur si referencë buxhetin e miratuar për këtë artikull, për vitin 2024 si dhe duke u mbështetur në nevojat e kërkesat e identifikuara në mënyrë analitike nga çdo strukturë në KLGJ. Këto kërkesa buxhetore janë parashikuar të përdoren për “Materiale zyre dhe të përgjithshme”,

“Materiale dhe shërbime speciale”, “Shërbime nga të tretë” , “Shërbime transporti”, “Shpenzime udhëtimi”, “Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme”, “Shpenzime për detyrime dhe kompensime legale” për vendimet gjyqësore, si dhe “Shpenzime të tjera operative”.

Gjithashtu kemi programuar edhe në shpenzime të tjera korrente, artikulli 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individë” të cilët rezulton në shumën 1,500 mijë lekë dhe të cilat janë parashikuar të përdoren për rimbursimin e telefonisë celulare për personat të cilët e përfitojnë atë sipas VKM-së në fuqi.

Kërkesa buxhetore për Shpenzime korrente, për vitin 2026, është programuar në shumën 432,100 mijë lekë dhe për vitin 2027, në shumën prej 433,100 mijë lekë.

Programimi në shpenzime kapitale, artikulli 231 “Investime/Aktive afatgjata materiale” janë programuar në shumën 15,000 mijë lekë dhe janë të njëjta me tavanët e miratuar. Këto shpenzime janë programuar të përdoren “Pajisje kompjuterike”, për “Orendi zyre” dhe për “Blerje Mjete Motorike”, për nevojat e KLGJ-së.

Kërkesat buxhetore për vitin 2026 dhe 2027, janë në shumën prej 15,000 mijë lekë, respektivisht për çdo vit, pra dhe brenda tavaneve buxhetore.

Kalojmë në programin e dytë të grupit buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor, që është “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë”. Kërkesat buxhetore edhe për këtë program janë mbështetur në vizionin, misionin, qëllimin, synimet dhe objektivat strategjike që ka Qendra e Teknologjisë së Informacionit.

Është hartuar deklarata e misionit, përshkrimi i programit, qëllimi i politikës së programit, deklarata e politikës së programit, objektivi i programit, treguesit e performancës në nivel objektiv, produkti i programit.

Kërkesat buxhetore për Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025-2027, për

Qendrën e Teknologjisë së Informacionit (QTI), së bashku me tavanet përgatitore, paraqiten sipas pasqyrës që ju të gjithë e keni poshtë dhe siç shikohet nga pasqyra këto janë programuar në vlerën 19,000 mijë lekë, dhe krahasuar me tavanet përgatitore prej 17,478 mijë lekë, rezultojnë më të larta në shumën prej 1,522 mijë lekë. Ndërsa shpenzime kapitale për Qendrën janë programuar në vlerën 0 lekë.

Shpenzime korrente janë të ndara në shpenzime personeli dhe shpenzime operative.

Shpenzimet e personelit janë të përbëra në shpenzime paga të cilat janë në 14,000 mijë lekë dhe rezultojnë më të ulëta sesa tavanët e miratuara në shumën 1,078 mijë lekë.

Ndërsa në Sigurime Shoqërore janë në shumën 2,000 mijë lekë dhe janë të njëjta sipas tavanëve, dhe janë përlllogaritur sipas legjislacionit në fuqi duke qenë se janë të njëjta edhe me tavanët përgatitore të miratuara.

Shpenzimet Operative janë programuar në shumën 2,976 mijë lekë dhe krahasuar me tavanet që janë 376 mijë lekë, janë më shumë, në vlerën 2,600 mijë lekë.

Kërkesat buxhetore janë parashikuar të përdoren “Materiale zyre e të përgjithshme”, “Shërbime nga të tretë”, “Shpenzime udhëtimi”, “Shpenzime të tjera operative” si dhe shpenzime për “Transferata për buxhetet familjare dhe individë”.

Duke evidentuar faktin që në shpenzime personeli tavanet janë më të larta se kërkesat tona, dhe tavanet përgatitore në shpenzime operative janë më të ulëta, kjo çështje do të jetë objekt diskutimi në negociatat me Ministrinë e Financës, për të bërë sistemimin e këtyre diferencave brenda tavanëve të miratuara.

Kërkesat buxhetore për shpenzime korrente, për vitin 2026, janë në shumën 19,100 mijë lekë dhe për vitin 2027, janë programuar në shumën 19,200 mijë lekë.

Siç theksova edhe më sipër, në shpenzime kapitale, kërkesa buxhetore janë programuar në shumën 0 lekë, pasi Qendra ngrihet dhe funksion pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili siguron ambientet e përshtatshme të punës. Funksionet mbështetëse horizontale, administrative, financiare e logjistike kryhen për qendrën nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Kalojmë tek programi i tretë që është edhe më i rëndësishmi i grupit buxhetor

Këshilli i Lartë Gjyqësor, që është “Buxheti Gjyqësor” i cili përfshin kërkesat buxhetore për funksionimin e veprimtarisë së gjykatave në të tre nivelet.

Edhe për këtë program buxhetor është hartuar përshkrimi i politikës së programit, qëllimi i politikës së programit, treguesit e performancës në nivel qëllimi, objektivi i programit, treguesit e performancës në nivel objektivi, produktet e programit, që janë shpenzime korrekte (çështjet e gjykuara) dhe shpenzime kapitale që janë: Blerje pajisje zyre, Blerje pajisje elektronike, Studime dhe Projekttime, Ndërtim godinë e re/Rikonstruksione, Blerje mjetesh motorike, Programe për softuerë, Programe softëare për sigurinë kibernetike.

Kërkesat buxhetore për vitin 2025, gjatë fazës së parë strategjike, në këtë program, janë programuar në shumën 7,582,400 mijë lekë, krahasuar me tavanet përgatitore të miratuara në shumën prej 4,490,560 mijë lekë, rezultojnë rreth 70% më të larta se tavanet përgatitore të miratuara ose në vlerë absolute në shumën prej 3,091,840 mijë lekë.

Programimi në shpenzime korrente, kërkesat buxhetore të programuara janë në shumën 5,206,400 mijë lekë dhe krahasuar me tavanet që janë në 4,305,560 mijë lekë rezulton të jenë në masën 21% më të larta sesa tavanet përgatitore të miratuara.

Kërkesat buxhetore në artikullin 600 “Shpenzime për paga”, janë në shumën 4,042,000 mijë lekë.

Programimi i kërkesave buxhetore për shpenzime të pagave, gjatë fazës së parë strategjike, është bërë për numrin 1,615 punonjës sipas strukturës organizative (trupë gjyqësore dhe administratë gjyqësore) si dhe për kërkesën për shtesë për 212 punonjës shtesë që janë bërë nga gjykatat si dhe për 39 punonjës me kontratë të përkohshme. Programimi është bërë sipas legjislacionit në fuqi për pagat. Këtu janë mbajtur parasysh edhe disa tregues që kanë ardhur nga struktura përgjegjëse, Departamenti i Burimeve Njerëzore në Këshillin e Lartë Gjyqësor e cila është struktura përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore në sistemin gjyqësor.

Për vitin 2025, kanë paraqitur 15 gjykata 212 kërkesa për shtimin e pozicioneve në strukturën organizative, në pozicione të ndryshme, në administratën gjyqësore, si:

Ndihmës Ligjorë, Kryesekretar, Sekretare, Shef Sektori, Specialist të ndryshëm, Shofer, Ftues, Punonjës sigurie, Sanitar, Magazinier, Mirëmbajtës. Gjithashtu është mbajtur parasysh edhe numri i kandidatëve për magjistratë që do mbarojnë shkollën në vitin 2024 si dhe numri i kandidatëve për ndihmës ligjorë që mbarojnë shkollën në vitin 2024. Po kështu po vazhdon edhe kualifikimi nga KLGJ për numrin e kandidatëve në programin fillestar për Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2024-2025, ku numri i kandidatëve për magjistrat/ profili gjyqtar është 20 dhe numri për ndihmës ligjor është 15.

Efeki financiar i kërkesës për 212 punonjës, sipas pozicioneve të mësipërme është në shumën 363,000 mijë lekë, respektivisht në shpenzime paga dhe në shpenzime sigurime. Efeki financiar i kërkesës për 39 punonjës me kontratë të përkohshme është në vlerën 29,000 mijë lekë.

Tavanet përgatitore të miratuara janë më të ulëta se kërkesa jonë, në svlerën 818,340 mijë lekë.

Pavarësisht vakancave në trupën gjyqësore dhe në administratën gjyqësore, tavanet përgatitore të miratuara për vitin 2025, mbeten të ulëta krahasuar me nevojat reale që ka gjyqësori. Duke pasur parasysh organikën faktike të gjykatave, si dhe duke pasur parasysh se gjykatat janë duke kryer procedura rekrutimi për plotësimin e vendeve vakante në administratën gjyqësore, kjo diferencë në shpenzime personeli vlerësojmë se duhet të merret në konsideratë.

Kërkesat buxhetore në “Shpenzime për Sigurimet Shoqërore e Shëndësore” janë programuar në shumën 460,000 mijë lekë, të cilat janë programuar duke u përlogaritur sipas legjislacionit në fuqi, dhe janë në të njëjtin nivel me tavanet përgatitore të miratuara.

Kërkesat buxhetore për Shpenzime operative (mallra dhe shërbime të tjera), janë programuar në shumën 698,000 në mijë lekë dhe krahasuar me tavanet përgatitore, paraqiten rreth 13% më të larta sesa tavanet e miratuara ose në vlerë absolute në 82,500 mijë lekë.

Kërkesat buxhetore për këtë grup shpenzimesh, janë parashikuar të përdoren nga gjykatat për blerje “Materiale të përgjithshme”, “Materiale dhe shërbime speciale”,

“Shërbime nga të tretë”, ku në shërbimet për të tretët pjesë të rëndësishme zënë shpenzimet e pastrimit dhe gjelbërimit, shërbimet e sigurisë dhe të ruajtjes së godinave dhe RDA-së, shërbim dhe mirëmbajtje të RDA-së, sistemit audio dhe video të seancave gjyqësore, shërbime të mirëmbajtjes të programit financiar, shërbimi i mirëmbajtjes së sistemit të menaxhimit çështjeve ICMIS si dhe shërbime të tjera për ekspertë, përkthyes, avokatë kryesisht, vlerësues, psikologë, etj, me qëllimin e vetëm sigurimin dhe funksionimin normal të aktivitetit të gjykatave të të tre niveleve.

Një pjesë e madhe e këtij grupi shpenzimesh do të administrohen nga KLGJ-ja 03310. Gjithashtu këto fonde janë parashikuar të përdoren edhe për shpenzime transporti, shpenzime udhëtimi, shpenzime mirëmbajtjeje të zakonshme, shpenzime për detyrime dhe kompensime legale si dhe për shpenzime të tjera operative.

Gjithashtu në shpenzime të tjera korrente, në artikullin 606 janë programuar fonde për shpenzime për transferta për buxhete familjare dhe individë që janë programuar të përdoren për pagesat e interesave të kredive të përfituara nga magjistratët dhe rimbursim të shpenzimeve të telefonisë celulare për personat të cilët përfitojnë këtë pagesë sipas VKM-së në fuqi.

Kalojmë tek pjesa më e rëndësishme që është programimi i shpenzimeve kapitale (investime) për buxhetin e gjykatave.

Në total kërkesat buxhetore për “Shpenzime Kapitale (investime)” janë programuar në shumën 2,376,000 mijë lekë.

Kërkesat buxhetore janë programuar bazuar në kërkesat e ardhura nga të gjitha gjykatat, databazës që disponon struktura përgjegjëse për investime, si dhe janë parashikuar të përdoren kryesisht për studime-projektme, ndërtime, rikonstruksione, pajisje të ndryshme IT, orendi dhe pajisje mobilie zyre, mjete transporti dhe pajisje të tjera teknike. Një rol të veçantë në evidentimin dhe hartimin e kërkesave buxhetore kanë luajtur edhe materialet e përgatitura dhe relacionet e përgatitura nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit në KLGJ, e cila konsiston më së shumti në programe softuerë për gjykatat e të gjitha niveleve.

Kërkesat buxhetore për këtë grup shpenzimesh, në mënyrë analitike paraqiten, si

më poshtë:

Artikulli 230 “Investime afatgjata jo materiale” kërkesat buxhetore janë programuar në shumën 83,850 mijë lekë. Të gjitha këto shuma janë të përfshira në kodin e projektit Studime dhe Projekttime dhe janë programuar të përdoren për studim projektim për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, si dhe për Gjykatën të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Të gjitha këto janë në funksion të projektit të zbatimit për ndërtimin e gjykatave të reja. Të gjitha këto kanë bashkëlidhur dokumentacionin siç e keni të cituar por edhe siç e kemi dërguar edhe me e-mail të gjitha relacionet argumentues sipas natyrës së kërkesave.

Po kështu është proframuar edhe për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë vlera prej 6,850 mijë lekë, në lidhje me instalimin e një sistemi të ri ngrohje-ftohje-ventilim. Gjykata këtë e ka argumentuar dhe ka sjellë edhe materialet e duhura. Gjykata ka kërkuar fonde 3,850 mijë lekë për realizimin e këtij shërbimi.

Po ashtu gjykata ka kërkuar gjithashtu të bëjë zëvendësimin e sistemit aktual BMS, (Building Automatic System), i cili menaxhon elektronikisht të gjithë sistemin elektrik, ndriçimin, sistemin e ajrimit, sistemin e kondicionimit, sistemin e kaldajës etj. Edhe për këtë vlera është llogaritur në vlerën 3,000 mijë lekë.

Për vitin 2026 janë programuar fonde për projektin e zbatimit për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe për vitin 2027 janë programuar fonde për projektin e zbatimit për ndërtimin e godinës së re të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.

Kalojmë në artikullin 231 “Investime afatgjata materiale”. Kërkesat buxhetore për këtë artikull janë programuar në shumën 2,292,150 mijë lekë. Siç ne tashmë jemi në dijeni, ndërtimi i godinave të reja shtrihet në disa vite buxhetore.

Projekti “Ndërtim i ri dhe rikonstruksion i plotë” kërkesat buxhetore janë programuar në shumën 1,015,250 mijë lekë, nga të cilat 900,000 mijë lekë për ndërtesa të reja dhe diferenca tjetër është për rikonstruksione të pjesshme dhe të plota.

Për ndërtimin e godinave të reja janë parashikuar: për Gjykatën e Lartë, kostoja e

përafërt e investimit është parashikuar në shumën 1,100,000 mijë lekë. Siç jemi në dijeni, qëllimi i këtij projekti të investimit është ofrimi i kushteve optimale të punës dhe sigurisë për gjyqtarët dhe stafin mbështetës të Gjykatës së Lartë, si dhe ofrimi i një shërbimi cilësor dhe transparent për publikun.

Kostoja paraprake siç e citova më sipër është 1,100,000 mijë lekë. Ky projekt është parashikuar të shtrihet në 3 vite. Në vitin 2025 është programuar shuma 40 mijë lekë (400.000) në vitin 2026 - 40 mijë lekë (400.000) dhe në vitin e fundit buxhetor 300.000 mijë lekë. Duke marrë të mirëqenë që do të realizohet projekti i zbatimit brenda këtij viti buxhetor për të cilat janë detajuar edhe fondet.

Po kështu kemi programuar edhe ndërtimin e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Vlera e përafërt e këtij investimi është parashikuar 603,000 mijë lekë. Për vitin e parë 2025 është programuar shuma 200,000 mijë lekë, në vitin 2026 - 200,000 mijë lekë dhe në përfundim 203,000 mijë lekë.

Gjithashtu është parashikuar edhe ndërtimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Kostoja e përafërt e investimit është 1,500,000 mijë lekë.

Për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë projekti i investimit është mbështetur nga hapi i parë i Hartimit të Detyrës së Projektimit e cila ka përfunduar. Ky dokument është përgatitur gjatë vitit të kaluar, në bashkëpunim me përfaqësues të KLGJ, përfaqësues të institucioneve përfituese të Prokurorisë së Përgjithshme si dhe specialistë të Bashkisë Tiranë. Detyra e projektimit ka trajtuar nevojat për sipërfaqe pune për të dy gjykatat por edhe për prokuroritë e të dy niveleve.

Në Programin Buxhetor 2025-2027 është programuar realizimi i projektit të investimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe duke filluar për vitin 2025 - 300,000 mijë lekë, në 2026 - 400,000 mijë lekë dhe për vitin 2027 - 800,000 mijë lekë.

Kërkesat buxhetore për 2026 janë programuar për fillimin e ndërtimit të godinave të reja për Gjykatën Durrës dhe Gjykatën Fier. Ndërsa për vitin 2027 kërkesat buxhetore

janë programuar për ndërtimin e godinës së re për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Në rikonstruksione vlera e programuar në rikonstruksione të tjera ndërtimore të pjesshme dhe të plota, vlera e programuar është në shumën 115,250 mijë lekë dhe është parashikuar të përdoren kryesisht për rikonstruksionin e pjesshëm të 5 godinave: të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ndërsa për vitet buxhetore 2026 dhe 2027, “Rikonstruksione të tjera ndërtimore” nuk janë paraqitur kërkesa buxhetore nga gjykatat, por nisur nga historiku i kërkesave buxhetore për rikonstruksione të pjesshme të 3 viteve të kaluara, janë programuar fonde të cilat do të detajohen sipas nevojave që do paraqiten më pas nga gjykatat, në shumën 110,000 mijë lekë për vitin 2026 dhe në shumën 120,000 mijë lekë për vitin 2027.

Projektet e parashikuara në programe blerje “Programe Softuerë” për gjykatat.

Kërkesat buxhetore janë programuar në shumën 837,700 mijë lekë dhe konsistojnë në “Instalimin e sistemit të kompjuterëve”, (blerje të Programe Softuerë) në shumën 837,700 mijë lekë, të cilat konsistojnë në:

Projektin për zhvillimin e një sistemi të ri të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, që tashmë ne kemi dy vite që e programojmë dhe nuk po arrijmë ta financojmë dhe ta realizojmë.

Rritja e kapaciteteve të sigurisë kibernetike, Këshilli i Lartë Gjyqësor synon të zgjerojë strategjinë e zgjidhjes së mbrojtjes së të dhënave nga sulme të mundshme kibernetike, serverët virtualë apo fizikë që ka në infrastrukturën ekzistuese.

Vlera e këtij projekti është parashikuar të realizohet për një periudhë 1-vjeçare, pra për vitin buxhetor 2025 në shumën 168,520 mijë lekë. Për këtë dua të theksoj që në lidhje me sigurinë kibernetike, dje në Këshillin e Lartë Gjyqësor ka ardhur një shkresë nga AKCESK për të përfshirë në parashikimet e PBA 2025-2027 efektin financiar për tre vitet buxhetore, bazuar në ligjin 25/2024 “Për sigurinë kibernetike” përkatësisht për vitin

2025 në shumën 90,000 mijë lekë, për vitin 2026 në shumën 145,637 mijë lekë dhe për vitin 2027 në shumën 49,835 mijë lekë. Duke qenë se për sigurinë kibernetike Departamenti i IT-së ka programuar fondet siç citova më sipër, një fazën e dytë të PBA-së do të marrim në konsideratë edhe vlerësimin e efekteve financiare të bëra dhe të dërguara nga AKCESK-u.

Tjetër projekt është edhe Enterprise Service BUS (ESB), Implementimi i këtij projekti do të ndihmojë KLGJ-në me qëllim për të ofruar një qasje të unifikuar për komunikimin midis shërbimeve. ESB do të veprojë si një pikë qendrore e identifikimit dhe autorizimit, duke ofruar një qasje të sigurt dhe të standardizuar për komunikimin midis shërbimeve.

Ky projekt është parashikuar të realizohet në një periudhë 2-vjeçare në shumën 406,000 mijë lekë, për vitin 2025 janë programuar në shumën prej 203,000 mijë lekë dhe për vitin 2026 janë programuar në shumën prej 203,000 mijë lekë.

Tjetër projekt i propozuar nga Departamenti i IT-së është zgjidhja e qendëruar raportimi dhe BI. Bazuar në detyrimet ligjore të ligjit 115/2016 i ndryshuar, prej kohësh sistemi gjyqësor kishte nevojë për një mënyrë të qendëruar raportimi dhe inteligjence biznesi BI për të siguruar raporte të përmbledhura dhe gjithëpërfshirëse rreth statistikave të përgjithshme të të gjithë gjykatave të të tre niveleve dhe secilës gjykatë në veçanti.

Ky projekt është parashikuar të realizohet në një periudhë 2-vjeçare në shumën prej 16,360 mijë lekë, të cilat për vitin 2025 janë parashikuar në shumën 8,180 mijë lekë dhe për vitin 2026 në shumën 8,180 mijë lekë.

Tjetër projekt është edhe Integrimi i Inteligjencës Artificiale në proceset e punës.

Ky projekt është parashikuar të realizohet në një periudhë 2-vjeçare në shumën 487,200 mijë lekë, të cilat për vitin 2025 janë programuar në shumën 243,600 mijë lekë dhe për vitin 2026 në shumën 243,600 mijë lekë.

Gjithashtu është programuar edhe për Gjykatën e Lartë, një fond prej 2,100 mijë lekë për blerjen e tre softeve: një për qendrën e dokumentacionit, një për krijimin e faqes ëeb të Ked-it, dhe një për krijimin e robotit AI për nxjerrjen e relacioneve të vendimeve.

Për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e

Organizuar, janë programuar një fond prej 300 mijë lekë pasi është e nevojshme të blihet program kompjuterik për kthimin e dokumenteve nga PDF në ËORD Excel, si dhe licenca për 10 paketa Office për t'u përdorur çdo vit buxhetor për periudhën 2025 – 2027.

Gjithashtu janë programuar fonde për “Blerje pajisje elektronike” për sistemin gjyqësor, në vlerën 109,200 mijë lekë, të cilat konsistojnë në blerje Server, Rack Cabinet për 8 gjykata si dhe pajisje autovizuale (monitor, aparat, pajisje fonie, sisteme konferencash, ekrane), kërkesa të cilat janë parashikuar të përdoren për të plotësuar nevojat për 9 gjykata, si dhe plotësimin po për 9 gjykata për pajisje të tjera teknike (Scanner, Router, Sëitch, Storage për server, Hard disk, Tablet).

Gjithashtu edhe për blerje “Fotokopje”, janë kërkesat buxhetore paraqitur nga katër gjykata.

Për blerje “Pajisje kompjuterike” kemi nga 20 gjykata në shumën 60,640 mijë lekë, të cilat janë parashikuar për t'u blerë 330 kompjuter të rinj dhe 8 laptopë.

Për “Pajisje të tjera zyre” (Printer, UPS Kompjuteri, UPS për server), në shumën 12,930 mijë lekë, të cilat janë parashikuar të përdoren kryesisht për të plotësuar nevojat e paraqitura nga 17 gjykata.

Gjithashtu kemi edhe për “Blerje pajisje zyre”, të cilat janë programuar në shumën 263,700 mijë lekë, të cilat konsistojnë në blerje "Pajisje të tjera zyre (grila, inverter, stabilizator tensioni, stendë, etj.) si dhe blerje "Pajisje dhe instalim kondicioneri" për të plotësuar kërkesat e pesë gjykatave.

Gjithashtu këto konsistojnë edhe në blerje "Pajisje për mbrojtjen kundra zjarrit" dhe janë parashikuar të përdoren për të plotësuar nevojat e paraqitura nga 4 gjykata.

Blerje "Pajisje për sistemin e sigurimit" Akses kontroll, Derë dedektimi, Skaner bagazhesh etj", kërkesa të cilat janë paraqitur për të plotësuar nevojat nga 10 gjykata.

Në këtë kod projekti përfshihet edhe “Projekti i sigurisë në gjykata”, i cili është diskutuar edhe në PBA-të e kaluara. Vlera totale e këtij projekti është parashikuar në shumën 446,400 mijë lekë dhe për vitin e parë buxhetor 2025 ky projekt është parashikuar në shumën 173,100 mijë lekë ndërsa diferenca është për vitin 2026 dhe për vijimin e punës pastaj edhe për vitet e tjera buxhetore.

Tjetër kërkesë buxhetore që është përllogaritur është blerje "Orendi zyre" në shumën 34,390 mijë lekë dhe janë parashikuar të përdoren kryesisht për të plotësuar nevojat për 11 gjykata.

Në fund kemi dhe kërkesat buxhetore të programuara për "Blerjen e mjeteve motorike", të cilët janë programuar për të plotësuar nevojat për sistemin gjyqësor për të blerë 22 copë automjete në vlerë totale 66,300 mijë lekë.

Ndërsa kërkesat buxhetore për vitet 2026 dhe 2027, për "Blerje mjete motorike" nuk janë paraqitur kërkesa buxhetore, por nisur nga historiku i blerjeve të automjeteve, janë programuar fonde të cilat do të administrohen nga KLGJ-ja 03310 në shumën 30,000 mijë lekë për 2026 dhe 30,000 mijë lekë për vitin buxhetor 2027.

Ndërsa, për vitin 2026 kërkesat buxhetore në "Shpenzime kapitale" janë programuar në shumën 2,397,280 mijë lekë dhe për vitin 2027, janë programuar në shumën 2,434,700 mijë lekë.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin buxhetor në Republikën e Shqipërisë, në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozoj seancës plenare të KLGJ-së, shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave buxhetore sipas dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, faza e parë strategjike, për sistemin gjyqësor, sipas pasqyrave bashkëlidhur.

Ju faleminderit për vëmendjen, në pritje të ndonjë pyetjeje të mundshme.

Naureda Llagami: Shumë faleminderit për relacionin e detajuar.

Atëherë ftoj kolegët nëse kanë ndonjë pyetje.

Atëherë nëse jo, megjithatë prapë, për çdo pyetje apo çdo propozim kemi kohë që të reflektojmë. Gjithmonë e themi këtë. Kështu që, çdo nevojë që mund të kenë gjykatat, jemi akoma në proces me gjykatat që ne mund t'i reflektojmë deri në gusht. Kështu që unë propozoj që ta miratojmë në këtë fazë projektbuxhetin dhe për të lejuar më pas drejtorinë që të bëjë veprimet e tjera. Kështu që Irena, votim.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Naureda Llagami: Alban! Alban!

Fatmira Luli: Dakord.

Naureda Llagami: Prit, se është Albani. Albani!

Po, dakord. E kemi të shkruar. Faleminderit!

(Zoti Toro ka votuar nëpërmjet platformës dhe është dakord. Dokumenti do t'i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.)

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e dokumentit të kërkesave buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 (PBA 25-27), faza e parë, për sistemin gjyqësor (Këshillin e Lartë Gjyqësor, Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë dhe Gjykatat), sipas pasqyrave nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, bashkëlidhur pjesë e këtij vendimi.

2. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 26.04.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).¹

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:05 dhe mbaroi në orën 13:51.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli**** (anëtare)
- 4. Irena Plaku**** (anëtare)
- 5. Gentiana Muçaj*** (anëtare)
- 6. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 7. Alban Toro**** (anëtar)

¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e treta sipas rendit të ditës.

8. *Markelian Koça** (anëtar)
9. *Yllka Rupa** (anëtare)
10. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Illir Rusi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
4. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në hedhjen e shortit për caktimin e gjyqtarit për gjykatën në nevojë. Për më shumë detaje, fjalën e ka z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Deri më datë 26.04.2024, pranë KLGJ-së, është për trajtim kërkesa për caktim

gjqitari për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçanta, të Zëvendëskryetares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, sipas të dhënave të mëposhtme. Bëhet fjalë për dy kërkesa të cilat kanë natyrë penale. Të dhënat janë të integruara në relacionin përkatës. Nuk po ndalem.

Zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit dhe mekanizmi i transferimit të përkohshëm bëhet i pamundur për t'u aplikuar në këtë rast konkret. Ndoshtur në këto kushte propozohet zbatimi i mekanizmit të caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme.

Për nevojat e mësipërme të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm referuar nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin”, si dhe vendimeve të nxjerra për këtë qëllim nga KLGJ, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta penale të jetë 2(dy).

Në opsionin e pranimit të propozimit si më lart, për hapat e shortit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon: Për 2(dy) çështje, për të cilat kërkohet respektivisht nga (një) gjyqtar, të përzgjidhen me short 2(dy) të tillë nga gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

Përfundimet nga shorti: Referuar paragrafit VIII të Vendimit të KLGJ-së, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon: Të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, konkretisht: z. {...}.

Ky është relacioni që unë kam përgatitur për hedhjen e çështjeve në short.

Nëse ka pyetje nga kolegët.

Naureda Llagami: Jo nuk ka pyetje. Kalojmë në hedhjen e shortit.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 113, gjyqtar i përzgjedhur z. Fatmir Ndreu.

Për çështjen nr. 22/67, gjyqtar i përzgjedhur z. Mikel Hysometaj.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Jemi dakord? Irena!

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Naureda Llagami: Alban!

Markelian Koça: Dakord.

Naureda Llagami: Po! E shkroi.

(Zoti Toro ka votuar nëpërmjet platformës dhe është dakord. Dokumenti do t'i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.)

Markeliani u shpreh.

Yllka!

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 26.04.2024)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 256, 257 dhe 258 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).²

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:05 dhe mbaroi në orën 13:51.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli**** (anëtare)
4. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
5. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
6. ***Alban Toro**** (anëtar)
7. ***Markelian Koça**** (anëtar)
8. ***Yllka Rupa**** (anëtare)
9. ***Emona Muçi*** (anëtare)

² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e dyta sipas rendit të ditës.

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Ilir Rusi**.

Shënim 2: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje **znj. Irena Plaku**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 5. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 256, 257 dhe 258 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në aktin e fundit për sot që edhe kjo ka të bëjë me shortin për fillimin e procedurave. Për më shumë detaje z. Kurushi. Shkurtimisht.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Ndjesë, sepse nuk e kisha hapur mikrofonin.

Po lexoj listën e shtojcës, listën e gjyqtarëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim. Kjo do të na duhet për të përcaktuar më tej vijimin e procedurave për hedhjen në short të relatorit. Gjyqtarët janë: Z. {...}, Z. {...}, Znj. {...}, Znj.{...}, Znj. {...}, Znj. {...}, Znj. {...}, Z. {...}, Znj. {...}, Znj. {...}, Znj. {...}.

Siç rezulton nga përmbajtja e shtojcës III, në këtë listë përfshihen edhe kandidatët

për pozicionet nr. 256, nr. 257 dhe nr. 258 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë që janë konkretisht: z. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}.

Në pozicionet nr. 256, nr. 257 dhe nr. 258 fillimisht ka aplikuar edhe z. {...}, në kushtet kur për këtë kandidat, Këshilli me vendimin nr.45/2024 vendosi: “Transferimin në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”.

Më tej, propozimet e Komisionit:

Sa më sipër, rezulton që në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të ketë kandidatë të kualifikuar për transferim nëpërmjet lëvizjes paralele, ku shumica e të cilëve kanë kandiduar për tre pozicione, në bazë të së drejtës së dhënë nga ligji, konkretisht neni 43, pika 5, e Ligjit për Statusin.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit projektvendimin “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për pozicionet e lira, të shpallura përkatësisht me vendimet nr. 256, nr. 257 dhe nr. 258, të vitit 2023.

Po ashtu, sipas këtij projektvendimi, Këshilli do të duhet të caktojë relatorin për çdo procedurë përzgjedhjeje për transferim nëpërmjet lëvizjes paralele. Lidhur me këtë, sipas projektvendimit, Komisioni ka vlerësuar që në rrethanat kur janë 3 (tre) pozicione të lira që i përkasin të njëjtës gjykatë e fushë, është propozuar që relator përzgjedhës të jetë një anëtar për të tre pozicionet, duke përfshiruar Kryetarin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, për shkak të ngarkesës.

Lidhur me procedurën e shortit, do të jetë ajo e ndjekur në rastet e ngjashme: në një enë të hidhen shiritat e letrës me emrat e 2 (dy) anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Më pas, shorti të vijojë me tërheqjen e një prej shiritave të letrës në enën me emrat e anëtarit të Komisionit, i cili ngarkohet si relator për pozicionet përkatëse, sipas përcaktimit në pikën 8-9 të këtij relacioni.

Projektvendimi është i propozuar të jetë i strukturuar në 2 pika, bashkëlidhur këtij relacioni dhe unë nuk po i lexoj. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, ftojme administratën e cila shpejt të veprojë me

përgatitjen e procedurës së shortit.

Procedura e shortit si vijon:

Futen në enën e qelqit emrat e relatorëve të Komisionit: z. Alban Toro, z. Markelian Koça.

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 256, nr. 257 dhe nr. 258, datë 24.05.2023, relator përzgjidhet z. Alban Toro.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit! Genta!

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Naureda Llagami: Albani!

Shkruajti. Po!

(Zoti Toro ka votuar nëpërmjet platformës dhe është dakord. Dokumenti do t'i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.)

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli, vendosi:

1. Fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 256, nr. 257 dhe nr. 258, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit për këto procedura, i cili është z. Alban Toro.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Duke ju falënderuar për angazhimin dhe për pjesëmarrjen, punë të mbarë dhe fundjavë të mbarë.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor